



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 34/2015

Prishtinë, më 20.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje - anëtarë.

I ftuar: z. Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Milazim Krasniqi, Agim Thaçi dhe Nazmi Zenelaj – MZHE; Lumnije Murati – ZPRK; Lejla Selimi – OSBE; Norë Shabani, gazeta “Koha Ditore”, Resmije Ballazhi – Rrokum TV; Arsim Rashiti – KosovaLive; Berat Thaçi dhe Blend Hyseni - GAP; Dardan Abazi – INDEP; Nora Kelmendi – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.10.2015;
3. Raportim i z.Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e Ministrisë, në realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Energjia, minierat, agjencitë e pavarura në fushëveprim dhe ndërmarrjet publike);
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari Muhamet Mustafa, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të datës 13.10.2015, të zhvendoset si pikë e tretë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga z.Mustafa.

2. Raportim i z. Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e Ministrisë, në realizimin e prioriteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm (Energjia, minierat, agjencitë e pavarura në fushëveprim dhe ndërmarrjet publike)

Kryetari, sipas programit të punës, kemi paraparë që tri ministrinë që janë brenda fushëveprimit të Komisionit, të raportojnë në Komision lidhur me zhvillimet, sidomos zhvillimet në aspektin buxhetor, sfidat e sektorit për vitin e ardhshëm, në mënyrë që deputetët dhe Komisioni, të jenë të informuar rreth aktivitetetve të tyre dhe projekteve zhvillimore. Ky sektor, shtoi ai, është shumë i rëndësishëm dhe ka një ndikim shumë të madh në zhvillimit ekonomik. Të gjithë e dimë se gjatë tërë këtij viti kanë qenë shumë aktuale çështjet që ndërlidhen me energjinë, minierat dhe ndërmarrjet publike, prandaj sot do të informohemi nga afër se cilat janë sfidat dhe zhvillimet e sektorit. Qëllimi i mbledhjes është që të shihet se çfarë duhet bërë Kuvendi dhe Qeveria, në mënyrë që gjërat të lëvizin më shpejt, në aspektin e marrjes së vendimeve dhe në aspektin e ekzekutimit të atyre vendimeve, tha z. Mustafa dhe ia dha fjalën ministrit.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, në ekspozenë e tij para deputetëve, paraqiti prioritetet, projektet dhe zhvillimet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Si prioritet themelor, kemi çështjen e energjisë dhe qëllimi është të kemi siguri të furnizimit me energji elektrike. Veprimi do të jetë i kombinuar në ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe në gjenerimin e tyre ekzistues. Negociatat me investitorin amerikan për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, janë në përfundim e sipër dhe nga fundi i këtij muaji, do të kemi një takim që mund të jetë takimi i fundit për të marrë dritën e gjelbër realizimi i ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”. Duke qenë pjesëmarrës aktiv në Komunitetin e Energjisë të Traktatit në Vjenë, kemi në fokus edhe eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme. Në Tiranë, në takimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, kemi dikutuar për dy projekte, projektin “Kosova e Re” dhe interkoneksionin, linjën 400 kilovoltëshe. Me Shqipërinë, po ashtu, kemi diskutuar edhe për pjesën legislative. Së shpejti do të vijë nga Qeveria në Kuvend edhe katër projektligje për energjinë, që janë pjesë e pakos së tretë energjetike. Lidhur me eficiencën, projekti me Bankën Botërore ka nisur, është një kredi prej 31 milionëve të cilën e ka aprovuar edhe Kuvendi, ku do të investohet në eficiencën e ndërtesave publike të nivelit qendror dhe nivelit lokal. Kursimi përmes masave eficiente është mjaft i lartë dhe kursimi i shprehur në vlerë monetare është rreth 200 milionë euro. Si obligim nga Traktati, kemi edhe Fondin për eficiencën, dhe për këtë qëllim, kemi kryer një studim të fizibilitetit. Nga vlerësimet që janë bërë nga ky studim, shohim se me projektin e eficiencës, në 5 vitet e ardhshme, mund të krijohen 11 mijë e 851 vende pune. Sa i përket burimeve të ripërtëritshme, kemi themeluar një

grup punues dhe kemi paraparë që me amendamentimin e Ligjit për eficiencën, të përfshihet edhe fondi. Është themeluar një grup punues për të thjeshtuar procedurat për leje dhe licenca sipas modelit ONE-STOP-SHOP, në mënyrë që investitorët të mos enden nga një zyrë në tjetrën, por të kenë mundësi që në një zyrë të kryejnë të gjitha procedurat. Sa i përket minierave, me një vendim të Qeverisë, kemi themeluar një grup punues për sektorin minerar, i cili ka për detyrë që të jepë rekomandimet elementare sa i përket të ardhmes së sektorit. Edhe ju si Komision parlamentar do të jeni pjesë e këtij grupi punues dhe mund të kontriboni me vizionet e juaja për sektorin minerar. Telekomunikacioni, po ashtu, është një sektor i rëndësishëm dhe për sektorin privat të teknologjisë do të jetë një park i cili do të vihet në shërbim të sektorit privat të teknologjisë informatike. Po ashtu, ministria do të hartojë një strategji për sektorin e teknologjisë informatike, me të cilën do të parashihet edhe themelimi i një fondi që do të mbështesë këtë sektor. Lidhur me ndërmarrjet publike, kemi bërë raportin dhe e kemi diskutuar në nivel të Komitetit Ndërmarrësor për Ndërmarrjet Publike dhe janë ngritur edhe disa çështje për plotësim dhe së shpejti do të miratohet në Qeveri dhe do të vijë në Kuvend. Kemi si ide që të kemi një ligj të ri për ndërmarrjet publike apo plotsim- ndryshim, i cili në masë të madhe do të evitojë mangësitë ekzistuese ligjore që janë shfaqur në të kaluarën.

Kryetari, pyeti: si është situata buxhetore e Ministrisë, si ka shkuar buxheti këtë vit dhe shpenzimet, si dhe a pritni që kufizimet buxhetore të jenë problematike për Ministrinë?

Ministri, në këtë vit nuk kemi pasur probleme të theksuara, por kemi shqetësime për vitin e ardhshëm, sepse kufizimet buxhetore neve na tangojnë në dy pika esenciale. E para, lidhet me investimet kapitale, janë mjete të planifikuara, janë marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës për financim, e vlera e tyre ashtu si është buxheti paraqet problem për t'i realizuar ato vitin e ardhshëm, diku në vlerë prej 2.8 milionë euro, shikuar në total. E dyta, lidhet me buxhetin për Fondin për eficiencë të energjisë dhe zhvillim të teknologjisë informatike. Shpenzimet për këto dy fonde kapin vlerën prej 4.7 milionë euro për tri vite.

Kryetari, tha se mund të konstatojmë se kemi ligje të rëndësishme në përpjekjet e Ministrisë. Sa i përket eficiencës së energjisë, orientimet janë që të krijohet fondi për eficiencë, si dhe kursimet përmes eficiencës së energjisë. I inkurajojmë që projektet të shkojnë deri në fund, për të gjetur një fond për energjinë e ripërtëritshme. Teknologjia e informacionit, po, ashtu, është një fushë shumë e rëndësishme për Kosovën dhe duhet të punohet që të depërtohet në zhvillimin e këtij sektori. Ne kemi pritur një progres më të shpejt, sidomos të sektorit të energjisë dhe presim strategjinë e energjisë, që ta diskutojmë këtë strategji dhe të zgjidhim dilemat që i kemi, e që nuk janë të lehta, që të marrim përgjegjësi sa më gjërë e mos të mbetet përgjegjësia te një ministër apo një grup njerëzish. Për këtë është Kuvendi, që të gjejë zgjidhjet më të mira, të angazhojë ekspertë që t'i zgjidhin ato dilema, ndërsa përgjegjësia të merret edhe nga Kuvendi. Ajo që është strategjike për ne si Kuvend, nuk duhet të vijmë në një situatë kur do të rritet importi, e kjo do të rritë çmimin e energjisë. Kosotoja e energjisë, nëse nuk mund të zvogëlohet, atëherë të mos rritet e të mos bjerë në koston e buxhetit të Kosovës. Projektligji për Trepçën, duhet të vijë sa më shpejt në Kuvend. Gjithashtu, lidhur me raportin e performancës së ndërmarrjeve publike, kemi kërkuar të vijë më herët, por është vonuar

dhe duhet të vijë sa ma shpejt. Këto janë çështje që janë në proces, nuk janë çështje të lehta e kuptojmë ndërlikueshmërinë, dhe ne jemi këtu që t'ju ndihmojmë të mos vijmë në pozitë që të kemi ngecje në këta sektorë, sepse krijohen probleme.

Raif Qela, tha se është mirë që po ndërmerren masa që sa ma shpejt të përfundojë procesi lidhur me tenderimin për ndërtimin e termocentralit të ri. Çka po ndërmerr Qeveria dhe Ministria, në mënyrë që mos të vijmë deri te një boshllëk të furnizimit me energji nga termocentralet tona dhe çka po ndërmerr që kjo të jetë sa me më pak pasoja? A e ka në shqyrtim Qeveria dhe ministria përkatëse mundësinë që të bëjë integritime në fushën e energjisë me Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që t'i zvoglojë dukshëm reduktimet e energjisë, duke pasur parasysh se janë komplementare hidroenergjitë e Republikës së Shqipërisë me termocentralet e Republikës së Kosovës? Kjo do ta zvogloonte në masë të konsiderueshme nevojën për investime në energji të ripërtëritshme për harmonizim me kërkesat e legjislacionit evropian. Lidhur me sektorin minerar, jam i shqetësuar me hapat e ngadalshëm që po mer Qeveria dhe Ministria për strategjinë dhe Ligjin për Trepçën. Të mos lihet që Trepça të shkojë në likuidim qysh ka qenë në rrezik të shkojë. Deri ku ka arritur strategjia dhe Ligji për Trepçën? Lidhur me telekomin, Kosova ka kodin telefonik të Monakos, dhe në mungesë të kodit të vet, ka humbur qindra miliona euro. Ky Kuvend në përbërjen e kaluar ka nxjerrë rezolutë që kodi telefonik të merret nga Shqipëria, sepse kjo do të kursente në masë të konsiderueshme rreth 10 milionë euro në vit. Sapo të fillojmë të marrim kodin telefonik të Shqipërisë, do të na lejohet kodi i Kosovës. Në fushën e teknologjisë së informacionit është reduktuar buxheti në këtë vit aq shumë sa do të dëmtohet rëndë e ardhmja e institucioneve. Agjencisë përkatëse, diku 91% e buxhetit të kërkuar, i është reduktuar. Nëse nuk ndërmirret diçka mund të krijohet kolaps në institucionet e Kosovës, pra janë bërë reduktime edhe aty ku nuk është dashur fare. Këtë çështje e kam ngritur edhe me rastin e rishqyrtimit të buxhetit, por nuk janë ndërmarrë masa dhe kështu mund të krijohen pasoja shumë të dëmshme. Çka është duke ndërmarrë Ministria që kjo çështje të mos përsëritet më, sepse pasojat janë tepër afatgjata?

Fatmir Rexhepi, tha se është bërë praktikë në Kuvend dhe në të gjitha qeveritë, që çdo dy apo tri vite t'i ndryshojnë dhe plotësojnë strategjitë e fushave të caktuara, në këtë rast, edhe të fushave që mbulon kjo Ministri, por kur i shohim sa janë realizuar ato strategji, del shumë pak. Duhet të fokusohemi dhe të ecim me një dinamikë të përsheptuar në ndërtimin e kapaciteteve të reja. Po vjen fundi i vitit pa u realizuar asnjë projekt, pa pasur progres në asnjë projekt. Si do të na gjejë fundi i vitit 2016, e kemi dilemën? A do të na gjejë sërish pa kapacitete të reja? A do të na gjejë sërish pa rivitalizimin e kapaciteteve ekzistuese, për të cilat ka ofruar projekt edhe kompania gjermane? Nuk po bëhemi gati ta ndërtojmë një strategji, modelin e financimit, sesi do të duhej të ishte ai fond, nga do të vinte ai fond, si do t'i gjejmë burimet financiare për të financuar projektin për rivitalizimin e kapaciteteve ekzistuese. Ligji për Trepçën, që është përmendur shumë, mund të na gjejë edhe fundi i vitit tjetër pa Ligjin për Trepçën, sikurse po na gjen pa Bordin e AKP-së. Fondi i krijuar nga privatizimi nuk po mund të shfrytëzohet në drejtim të zhvillimit ekonomik. Ecuria është tepër e ngadalshme, duhet punuar më shumë dhe gjërat të ecin më shpejt, sepse kam dilema se fundi i këtij viti, por edhe i vitit tjetër, do të na gjejë pa progres.

Besim Beqaj, tha se e kuptoj se sa e vështirë është të zhvillohen projektet e mëdha, sepse ngërthejnë shumë interesa. Në këtë kohë kur po flasim për investime të mëdha dhe po dërgojmë mesazhe të këqija politike, nuk jemi duke i kontribuar fare zhvillimit ekonomik. Jostabiliteti politik do të ketë ndikim negativ në ekonomi, dhe nëse do të kemi një javë jostabilitet, atëherë duhen së paku katër javë për t'i i bindur bizneset për t'u kthyer në situatë normale. U tha këtu që ka një GAP potencial të furnizimit me energji elektrike, por edhe ministri tha se janë shumë të angazhuar që mos të kenë situata të tilla, të cilat krijojnë zbrazëti në furnizim me energji elektrike. Inkurajojmë Ministrinë që të orientohet në efikasitet të energjisë, si formë më e mirë për kursim të energjisë. Unë nuk pres që të kemi shkurtime të fondeve për efikasitet të energjisë, pasi që janë të bazuara në marrëveshje me Bankën Botërore. Përkrahja për efikasitet të energjisë, përveç sektorit publik, të orientohet edhe në sektorin privat. Në një konferencë rajonale për efikasitet të energjisë, kemi vërejtur se vendet e rajonit janë shumë të fokusuara edhe në përkrahjen e sektorit privat në efikasitet të energjisë. Shqetësuese mbeten bordet e ndërmarrjeve publike. Kjo është në kompetencë të ZKM-së, por ndikimi është në Ministri. Bordet duhet të jenë profesionale. Sa i përket kodit telefonik, rezoluta nuk ka qenë për të zëvendësuar, por për të biseduar me Shqipërinë për marrjen e kodit të Shqipërisë. Tani, përmes negociatave në Bruksel, jemi në drejtim të marrjes së kodit të Kosovës. Presim që strategjia dhe Ligji për Trepçën të vijnë sa më shpejt. Nga takimi i parë me ministrin, deri tash ka shumë gjëra që kanë lëvizur pozitivisht.

Blerim Grainca, tha se pajtohem me shumicën që u thanë këtu, sepse ne jemi vonuar me shumë gjëra si vend dhe si shoqëri në përgjithësi. Falënderoj Ministrin për gatishmërinë që të gjitha çështjet dhe problemet t'i diskutojë me Komisionin. Lidhur me teknologjinë e informacionit, sa i përket fondacionit, si do të jetë forma e operimit me këtë fond, cilët do të jenë mekanizmat për këtë fond, si do të jetë përfshirja e sektorit privat, kur dihet se biznesit privat i intereson kthimi i investimeve? Sa i përket ndërmarrjeve publike, sidomos ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, ka një dualizëm të madh në mes të ndërmarrjeve për grumbullimin e mbeturinave dhe ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave. Shpeshherë flitet për një monopolizim të këtij sektori dhe ka një kërkesë të vazhdueshme të pushtetit lokal për një decentralizim më të madh për bartjen e kompetencave, jo vetëm për grumbullimin, por edhe për menaxhimin e mbeturinave në nivel komunal. A është menduar që ky ligj të vijë dhe të rregullojë më mirë këtë fushë? Lidhur me çështjen e Trepçës, ka pasur premtime se Ligji për Trepçën do të vijë për dy apo tre muaj, por deri tani nuk ka ardhur. A është afër, a po punohet që ky ligj të silllet së shpejti në Kuvend? Çështja e privatizimit të telefonisë mobile, ku ka arritur si proces?

Sala Berisha – Shala - tha se i dëgjuam sfidat e Ministrisë, se pari mendoj që ne si ligjvënës kemi obligim t'i identifikojmë mangësitë ligjore të cilat veçse do ndërlikojnë me tepër sfidat tjera që përmendi edhe ministri; si Ligji për Trepçën, Ligji për ndërmarrjet publike. Vlerësoj punën e qeverisë që është duke punuar në Ligjin për NP. Dihet se si ka shkuar ky ligj në fillim të këtij viti. Me pak ndryshime në plotësim- ndryshimin e tij kanë mbetur shumë çështje tjera, të cilat duhet të rregullohen. Mandej, Ligji dhe strategjia për Trepçën janë çështje tjera po aq të rëndësishme. Mendoj që kompleksi "Trepça" nuk është problem vetëm i MZHE-se. Trepça është sfidë për tërë qeverinë e me gjërë. Trepça është sfidë shumëdimensionale, është sfidë politike, është sfidë menaxheriale, sociale,

ambientale. Te gjitha këto po edhe sfida tjera duhet ti ketë parasysh qeveria. Ministria po edhe qeveria duhet t'i shfrytëzoj kapacitetet njerëzore nëpër institucione përkatëse që lidhen me sektorin minerar si është bie fjala KPMM dhe SHGJK si dhe eksperte tjerë që kanë dhënë kontribut në Trepçë. Madje krahas kësaj duhet të marr ne shërbim edhe dokumente të rëndësishme në lidhje me sektorin. Në këtë drejtim do u sugjeroja që në kuadër të shfrytëzimit të të dhënave në sektorin minerar ta shfletoni/shfrytëzoni edhe librin shkencor "Trepça – Sfidat, ristrukturimi dhe perspektiva" është një dokument shkencor që i kushtohet një pjese të mineraleve të plumb-zinkut, arit e argjendit si dhe shtjellohen problematika dhe alternativat e rrugëzgjdhjeve të kompleksit "Trepça" si dhe mineraleve metalike. Sa i përket minierave, është e ditur se ne fare gjendje janë. Nuk kemi arritur ende që t'i materializojmë pasuritë natyrore minerale. Duhet të dinamizohet puna e institucioneve që ndikojnë në këtë drejtim si bie fjala, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, që është në kuadër të MZHE-se ka rol këshilldhënës për qeverinë. Qeveria duhet të shërbehet me të dhënat gjeoshkencore, që ka ky institucion në lidhje me pasuritë minerale. Kështu mandej qeveria do ta ketë një orientim të qartë në lidhje me sektorin minerar. Nisur nga fakti se SHGJK ka një rëndësi të veçantë në këshillimin e Ministrisë, duhet të fuqizohet ky shërbim. Këtë vit ka pasur shkurtime buxhetore dhe nuk është arritur që Shërbimi Gjeologjik i Kosovës të ketë një funksionim të mirëfilltë, ashtu siç është e përcaktuar me ligj. Një lajm i mirë që nuk e përmendi ministri, është se Shërbimi Gjeologjik i Kosovës është anëtarësuar në Shërbimin Gjeologjik Evropian çka do të thotë se anëtarësimi në mekanizma ndërkombëtar përveç tjerash ka edhe efektin e promovimit të Kosovës në kuptimin e pasurive minerale ashtuqë do të ndikon në joshjen e investitorëve të huaj. Madje në promovimin e resurseve minerale rol të rëndësishëm luajnë edhe konferencat ndërkombëtare siç janë ato për investime në miniera, e sidomos ato që mbahen për çdo vjet në Londër dhe Kanada. Sektori minerar ka nevojë të rishqyrtohet edhe në aspektin strategjik, si bie fjala 11 zonat e interesit të mbetura të pazhvilluara, duhet të hapet perspektive për zhvillimin e tyre. Këto zona janë të shtjelluara edhe në librin që e përmenda më herët. Formimi i grupi punues për miniera, nuk kuptova se kënd keni parapare të përfshihet?

Raif Qela, gjatë shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2014 të ARKEP-it, kryetari i Bordit të ARKEP-it tha se Autoriteti është në fazën finale të përmbylljes së procesit për dhënien e kapaciteteve frekuencore shtesë dy operatorëve, ku operatorët do të kenë edhe këtë aset shtesë, që iu ka munguar. Komisioni dhe Kuvendi nuk kanë marrë asnjë informatë plotësuese, përse nuk është realizuar ende ky premtim i kryetarit të Bordit të ARKEP-it, përse ende nuk iu kanë dhënë në shfrytëzim operatorëve mobilë resurset frekuencore shtesë nga ana e ARKEP-it?

Kryetari, tha se për ndërmarrjet publike që janë privatizuar ose që janë dhënë me koncesion, sikurse KEDS-i dhe Aeroporti, duhet që një trupë të monitorojë zbatimin e kontratës. Sa kemi informata, deri më tash kjo trupë nuk është krijuar. Roli monitorues i Kuvendit dhe i Ministrisë duhet të vazhdojë. Për atë që kemi informata për Aeroportin, duhet që çdo vit të monitorohet zbatimi i kontratës së koncesionit. Në të ardhmen, presim një raport sa i përket monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionimit të Aeroportit, në të gjitha aspektet, e njejtë vlen edhe për KEDS-in. Sot, pata një takim me një grup të sindikatave të këtyre ndërmarrjeve, të cilët shprehën shqetësime. Kjo trupë që e

monitoron zbatimin e kontratave dhe obligimeve duhet të jetë operacionale dhe ne duhet t'i monitorojmë këta operatorë privatë, që ofrojnë shërbime publike.

Ministri, sa i përket strategjisë së energjisë, po i presim këto vendime në fund të këtij muaji, rreth ndërtimit të termocentralit të ri, duke përfshirë edhe alternativat. Ideja është që investitori që vjen, të ketë një bagazh financiar. Partneriteti për projekte, në veçanti, interkoneksioni me Shqipërinë, është duke ecur mirë dhe deri në fund të marsit të vitit në vijim, sipas KOSTT-it, pjesa e Kosovës do të përfundojë. Ka një ide që kjo të bëhet një nyje e rëndësishme shkëmbyese për energji elektrike. Lidhur me kodin telefonik, si rezultat i negociatave që po ndodhin në Bruksel, do ta kemi kodin tonë. Aplikimin do ta bëjë Austria për ne dhe kodi do të jetë "+383". Lidhur me Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, nuk e përmenda anëtarësimin në Shërbimin Gjeologjik Evropian, por vlen të theksohet se kjo është një arritje e rëndësishme për sektorin minerar. Po ashtu, edhe KOSTT-i është pranuar si anëtar në Rrjetin Evropian të Transmisionit. Sa i përket reduktimeve buxhetore për Agjencinë e Informacionit, ju njoftoj se kjo agjenci nuk është në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por shkurtimet nuk duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë punën e institucioneve. Fondi për efikasitet të energjisë dhe fondi për sektorin e teknologjisë informatike, do të jenë fonde të reja ose fonde në kuadër të Fondit për zhvillim ekonomik dhe punësim. Efikasiteti i energjisë dhe teknologjia informatike pritet të sigurojnë rreth 20 mijë vende pune. Për Bordin e NP-ve dhe për Trepçën, mund të kemi edhe një takim të përbashkët me Kryeministrin, pasi që këto çështje janë më tepër në kompetencë të ZKM-së. Në grupin punues për Trepçën, do të mund të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit. Komisioni, ministria dhe institucionet tjera përgjegjëse për sektorin minerar, duhet të dimë si të marrim pjesë në ato konferenca që u përmendën. Pra, t'i shohim potencialet për investime, që t'i paraqesim në konferenca. Ndërmarrjet publike të mbeturinave, 7 janë komunale dhe 1 qendrore. Kanë dy çështje, pagat i rregullon Ministria e Financave, ndërsa menaxhimin Ministria e Mjedisit. Jemi duke diskutuar që ta kemi një model të njëjtë për të gjitha ndërmarrjet e mbeturinave. Sa i përket procesit të privatizimit të PTK-së, ne e kemi në program rishqyrtimin e strategjisë për privatizimin e PTK-së, por nga ana tjetër, ne kemi një proces kontestues dhe ndoshta mund të merren masat e mostjetërsimit, dhe në momentin që përfundon ai proces, ne do të vazhdojmë me privatizimin e PTK-së. Jemi të vetëdijshëm për kompleksitetin e projekteve të fushës së energjisë. Për projektin për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", në fund të muajit, do të merret vendimi. Rruga që kemi marrë lidhur me këtë projekt, presim të na shpie në rrugë të duhur. Spektri frekuencor është në përgjegjësi të ARKEP-it, ndërsa roli i Ministrisë është lehtësues. Kompania "IPKO" ka pasur ankesë për vlerën e çmimit. Sipas informacioneve, shumë shpejt pritet të jepen frekuencat shitesë për operatorët mobilë. Për koncesionimin e Aeroportit, të gjitha procedurat i ka udhëhequr Komiteti, me ndihmën e Njesisë për Partneritet Publiko-Privat, që ka shërbyer si sekretariat. Për KEDS-in është një njësi e postprivatizimit dhe brenda kontratës do të shohim dhe t'i zgjidhim edhe ankesat e sindikatës. Ne do të sigurohemi që askujt të mos i bëhet ndonjë padrejtësi. Ato që janë pjesë e kontratës, ne nuk mund t'i hapim dhe t'i rinegociojmë.

Muhamet Mustafa, tha se kemi para vetës probleme jo të lehta për të zgjidhur, të cilat kërkojnë një angazhim të përqendruar edhe pjesëmarrje të shumë aktorëve, në mënyrë që zgjidhjet të jenë sa më të mira në aspektin afatgjatë, ashtu edhe në aspektin emergjent

sipas nevojave që kemi. Duke diskutuar strategjinë e energjisë, duhet të diskutojmë dilemat dhe t'i zgjidhim, duhet të sigurohet një përkrahje më e madhe për këto zgjidhje optimale. Ky sektor përballët me probleme politike, ekonomike dhe sociale, por ne duhet ta mbështesim, që të merren vendime të shpejta, por edhe të mira. Sa i përket çështjes së GAP-it, të furnizimit me energji, ne duhet të diskutojmë kurdo që paraqitet ai GAP, pse paraqitet ai GAP. Nëse merret vendimi për ndërtimin e "Kosovës së Re", do të kalojnë disa vite, derisa të ndërtohet. "Kosova A" është shumë e shtrenjtë për ta mbajtur në këtë gjendje. Ne mund të vijmë në një situatë kur duhet të importojmë shumë. Importi do ta rritë çmimin dhe për këtë duhet të shohim punën e rivitalizimit. Është lajm i mirë që interkoneksioni ka shkuar mirë në anën e Kosovës, por duhet të bëjmë presion që edhe pjesa e Shqipërisë të përshejtohet. Ne duhet të angazhohemi më shumë rreth harmonizimit të sektorit energjetik me Shqipërinë, ndoshta edhe të integritetit të fushës energjetike. Duhet të shohim se çka duhet të bëjmë me fondin e privatizimit, sepse kemi nevojë për investime dhe ai fond duhet të zhbllokohet. Ju ministër, të na dërgoni një informatë se ku janë ato kufizime buxhetore, se ku mund t'ju rrezikojnë projektet me rëndësi vitale dhe ne gjatë shqyrtimit të buxhetit, të gjejmë një optimum. Çështja e minierave është problematike. Duhet ta bëjmë Ligjin për Trepçën, i cili kërkon shumë punë, por duhet të lëvizet më shpejt. Të analizohen rastet në vende të ndryshme, të dihet ku ka funksionuar mirë e ku jo mirë, dhe të kemi zgjidhjen më të mirë. Projektet janë mjaft të ndërlikuara, ndërthuren shumë dimensione, por me një përqendrim të Kuvendit, të Komisionit, të Qeverisë, të Ministrisë, mund të bëjmë hapa më të shpejtë t'i tejkalojmë këto probleme. Lëvizja në këto çështje është me rëndësi vitale që të krijojmë një situatë më të mirë në shoqëri, sepse është krijuar përshtypja, se në këtë shtet mungon perspektiva dhe kjo nuk është e vërtetë, nëse mungon perspektiva, atëherë ne jemi përgjegjës.

Pas debatit, Komisioni nxori këto

K o n k l u z i o n e:

- 1. Ministria t'i dërgojë Komisionit një raport, me të gjitha aspektet lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës së koncesionimit të Aeroportit dhe privatizimit të KEDS-it.*
- 2. Ministria t'i dërgojë Komisionit një informatë me shkrim, se cilat janë kufizimet buxhetore ku mund të rrezikohen projektet me rëndësi vitale, dhe Komisioni, gjatë shqyrtimit të buxhetit, të angazhohet që të gjejë një zgjidhje optimale.*
- 3. Ministria të angazhohet në adresimin e shqetësimeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit.*

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.10.2015

Kryetari, kërkoi nga deputetpët që nëse kanë ndonjë vërejtje në procesverbal, le t'i adresojnë sot ose t'i dërgojnë te stafi i Komisionit.

Raif Qela, tha se një pjesë e fjalës së tij nuk është përfshirë në procesverbal, andaj kërkoj që të përfshihet me tekstin si vijon: “Se kemi informacione të pamjaftueshme lidhur me rrjedhat në institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit dhe se komunikimi që e kemi me to, është i pamjaftueshëm, dëshmon p.sh. vetëm ky fakt: gjatë shqyrtimit të Raportit vjetor për vitin 2014 të ARKEP-it, kryetari i Bordit të ARKEP-it, z. Ekrem Hoxha, tha: “Autoriteti është në fazën finale të përmbylljes të dhënies së kapaciteteve shtesë frekuencore të dy operatorëve të autorizuar. (...) Autoriteti, brenda tre muajve të 3-të të këtij viti, do t’i ndajë resurset shtesë, me çka operatorët do të kenë edhe këtë aset të munguar të frekuencave shtesë”. Komisioni dhe Kuvendi nuk kanë marrë asnjë informatë plotësuese se përse nuk është realizuar ende ky premtim i kryetarit të Bordit të ARKEP-it. Përse ende nuk është dhënë në shfrytëzim ky resurs të cilin e kemi? Pse të mos u jepen dy operatorëve të telefonisë mobile licencat për operim edhe me brezin frekuencor 2100 MHZ, derisa nuk ekziston asnjë pengesë për këtë dhe përderisa ata kanë filluar ta ofrojnë shërbimin 4G? Pa këto frekuenca shtesë interneti në telefona mobilë është për katër fish më i ngadalshëm sesa sikur dy operatorëve të licencuar të telefonisë mobile t’u jepeshin edhe ato. Në këtë mënyrë, konsumatorët privohen nga një e drejtë, kurse biznesi i operatorëve, dëmtohet”.

Procesverbali i mbledhjes së datës 13.10.2015, u miratua duke përfshirë vërejtjen e z.Qela.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa